

VENDIM
Nr. 132, datë 21.5.2026

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 828/12 prot., datë 19.5.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hydrosolar Energy (HSE)’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hydrosolar Energy (HSE)” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 828 prot., datë 5.3.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet 2 mw, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 82, datë 19.3.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.3.2026 dhe 21.3.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.3.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 828/3 prot., datë 25.3.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 828/7 prot., datë 14.4.2026, MIE është shprehur parimisht dakord për fillimin e procedurave për pajisjen e shoqërisë me licencën e prodhimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 828/4 prot., datë 25.3.2026 dhe *email*-in e datës nr. 828/5 prot., datë 10.4.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Në vijim, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 105, datë 21.4.2026, vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me qëllim për t’i dhënë kohë shoqërisë të plotësojë dokumentacionin e munguar, pasi me *email*-in e datës 12.4.2026, shoqëria informon se shkresa e sipërcituar e ERE-s nuk ka shkuar në zyrën e saj dhe se ka marrë dijeni për të nëpërmjet *email*-it të ERE-s të datës 9.4.2026.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 828/9 prot., datë 20.4.2026, shoqëria depozitoi dokumentacion/informacion plotësues, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi se nevojitet sqarim/dokumentacion plotësues shtesë, ndaj ERE iu drejtua asaj me shkresën nr. 828/10 prot., datë 11.0.2026.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 828/11 prot., datë 14.5.2026, shoqëria ka paraqitur sqarime/dokumentacion shtesë për sa kërkuar.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat

dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

Shoqëria “Hydrosolar Energy (HSE)” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kontratën nr. 1188 rep., nr. 413 kol., datë 10.2.2026, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “Hydrosolar Energy” sh.p.k.”.

- Është pajisur me miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së OSSH sh.a. nr. 3381/3 prot., datë 4.7.2025.

- Është pajisur me VNM paraprase nr. AN 040420250012, lëshuar më datë 9.7.2025 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Impiantit Fotovoltaike”, me kapacitet 2 mw, e vlefshme deri më datë 9.7.2027.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka deklaruar se jetëgjatësia e centralit është 25 vjet, si e tillë, dhe vlefshmëria e kësaj licence do të jetë për 25 vjet.

- Shoqëria ka deklaruar se do të vërë në punë centralin brenda datës 25.12.2027, e cila është brenda afatit të vlefshmërisë të kontratës me MIE-n (deri më 10.2.2028), si e tillë vlerësohet që të përcaktohet dhe në vendim që shoqëria duhet të fillojë operimin brenda datës 25.12.2027.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n vlerësohet t’i lihet asaj kusht që, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës, dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Hydrosolar Energy (HSE)” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 25.12.2027.

3. Jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga fillimi i operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

4. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2 dhe 3 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Hydrosolar Energy (HSE)” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., “Furnizuesin e Tregut të Lirë” (FTL) sh.a. dhe shoqërinë “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti